REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 336/19
Datë/Datum. 24.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Korporata Energjetike e Kosovës

Numri i ProkurimitKEK-19-810-1-2-1

Sa i përket tenderit: Furnizimi me gjysumfabrikate(disqe)për punimin e dhëmbzorve.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"EURO-ING SHPK"Prishtinë
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ndue Perlleshi B6 44/1 Prishtinë
(Adresa)

Prishtinë10 000
(Vendi)
(Kodi postar)
044-610003, N/A
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Lavdim Ismajli
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

euroing.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara EURO-ING Prishtinë

24.06.2019
(Data e parashtrimit të kërkesës) (Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Hapja e tenderit 27.03.2019 ora 12:00. Njoftimi mbi vendimin e AK në E-Prokurim 05.06.2019. Kriteri kryesor për dhënie të kontratës-Tenderi i përgjegjeshëm me çmimin më të ulët. Kërkesa për rishqyrtim dt:10.06.2019 Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:14.06.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Gjeni të bashkangjitur KËRKESËN PËR RISHQYRTIM si dhe Vendimin e Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së për sa i përket nenit:

1. **Neni 1 i LPP-së**
2. **Neni 6i LPP-së**
3. **Neni 7 i LPP-së**
4. **Neni 59 i LPP-së**
5. **Neni 60 i LPP-së**

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenëte rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar autoriteti kontraktues na ka dërguar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm me dt:05.06.2019 dhe na ka njoftuar se fitues i këtij tenderi është shpallur OE "B&D Engineering".

Ne me dt :06.06.2019 kemi pasur qasje në dokuemntet e OE të rekomanduar për kontratë ku kemi vërejtur se ky OE është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara në nenin 9.1&9.2 ku është kërkuar *"1.Autenticitetit i*

*produkteve dhe cilësisë reprezentues,*ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar *"1.Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve qe ofroni".*

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një autorizim të prodhuesit Euro Sider, kurse autorizimi është i dhënë nga kompania Metal Element. Pra si diler në këtë rast është Metal Element por që në dojse nuk ka të bashkangjitur as kontratë e as autorizim ndërmjet liderit dhe dilerit ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe për këtë arsye ky OE është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk i ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara në nenin 9.1&9.2 ku është kërkuar 3.Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet, ndërsa dëshmi dokumentare është kërkuar "3.Certifikata(Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015).
Ky operator ekonomik e ka ofruar ISO certifikatën që është vetëm për prerje të metalit të karbonit, ndërsa nuk e ka për prodhimin e materialeve siç është kërkuar në FDT.

OE i rekomanduar për kontratë poashtu nuk ka ofruar specifikim për secilin artikull, ndërsa në FDT është kërkuar *"2.Mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve i vizatime të produkteve që duhet të furnizohen"*, ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar *"2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit katalogë e prodhuesit të produkteve të , bashkangjitur përshkrimit teknike detale për artikujt qe ofertoni nga prodhuesi . Nëse produktet janë ne katalogë sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen pozicionet e kërkuar".*

Në katalog nuk janë produktet dhe për një pjesë shumë të madhe nuk janë përshkrimet teknike detale, ndërsa Neni 39 i rregullave dhe Udhëzuesit operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) e parasheh shumë qartë:

- Është dorëzuar katalogu por mungon Specifikacioni teknik për mallrat e ofruara ---- Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm

Në vendimin e dt:14.06.2019 të AK-së për refuzim të kërkresës për rishqyrtim, autoriteti kontraktues është munduar të arsyetojë vendimine tyre paraprak, në dy pika sa i përket katalogut dhe autorizimit, ndërsa nuk është marr fare me pretendimin e tretë i cili ka të bëjë me Iso certifikatën.

Përfundimisht ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas nenit 60 të LPP-së dhe poashtu jemi diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Pra autoriteti kontraktues nuk e ka pasur parasysh nenin 60 paragrafin 1.1 të LPP-së, e që kjo dispozitë parasheh njërin ndër kriteret kryesore për dhënie të kontratës-tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, e i cili kriter ka qenë i përcaktuar edhe nga ana e autoritetit kontraktues si kriter kryesor i dhënies së kontratës, mirëpo AK-ja nuk e ka rekomanduar për kontratë OE të përgjegjshëm, por ka rekomanduar OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes sëtenderit dhe të njoftimit për kontratë.
Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, ankesa e **"EURO-ING SHPK"**si e bazuar,
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratësdhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatërivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vendimi i gabuar i Autoriteti Kontraktues ndikon dhe dëmton imazhin e kompanisë sonë, kurse ne dëme materiale shkelja e AK-së afekton një humbje materiale përafërsisht 5,000.00 €..

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*